



Datë: 30.10.2025

Numër Protokolli: 7083/2025

A.nr.1727/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1727/2025, të datës, 23.09.2025 të parashtruar nga ankuesi A.I, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 30.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1727/2025, të datës 23.09.2025, e parashtruar nga ankuesi A.I.

A r s y e t i m

Ankuesi (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 23.09.2025 fizikisht, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos nxjerrjen e aktit administrativ të organit të punësimit ndaj kërkesës së fundit të datës 23.07.2025 për kompensim të shtesës nga kushtet e tregut të punës prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.10.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa kjo e fundit më datë 15.10.2025, ka përcjell përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6293/2025 të datës 23.09.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Emalin e datës 14.05.2025; Akt emërimit me numër reference 229/ZDM-SH2 të datës 11.01.2023; Kontratën me numër protokolli 9849 të datës 26.12.2014 të MASHT-it ; Kërkesën e datës 23.07.2025 të ankuesit drejtuar organit të punësimit; Vendimin me numër protokolli 2674/2025 të datës 22.04.2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.10.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1727/2025 të datës 15.10.2025; Emalin e datës 27.02.2025; Emalin e datës 12.05.2025; Emalin e datës 19.08.2025; Emalin e datës 22.08.2025; përshkrimin e detyrave si dhe

vlerësimet e rezultateve në punë për vitin 2023-2024 të ankuesit; Dosjet e nëpunësve G.A dhe A.M për të cilët pretendohet se duhet të gëzojnë shtesën e lartë cekur.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e parakohshme, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me reference 229/ZDM-SH2 të datës 01.01.2023, mban pozitën e punës Zyrtar Ekzekutiv i Zëvendës Drejtorit Menaxhues -Shitje në Agjencinë Kosovare për Privatizim.

Tutje nga shkresat e lëndës, ankuesi më datë 23.07.2025, ka parashtruar kërkesën e fundit tek z. F.M përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e shtesës për kushte të tregut sipas rregullores 02/2023 të miratuar nga Ministri e Financave për shtesën dhe kushte të tregut të punës. Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve njerëzore z. M pas komunikimeve me z. A.A në Ministrinë e Financave lidhur me njohjen e shtesës për kushte të tregut për tre punonjësit e AKP-së, me datë 19.08.2025 ka pranuar emalin nga ky i fundit se kërkesat për zyrtaret e AKP-se lidhur me shtesën për kushte të tregut të dërgohen përmes emalit për shqyrtim. Tutje z M. me të njëjtën datë përmes emalit zyrtar ka kërkuar nga zyrtaret A.A, A.I (ankuesi), si dhe A.M se kërkesat lidhur me kompensimin e shtesës tani mund ti dërgoni në shqyrtim tek Komisioni, ku me datë 22.08.2025 z. M ka përcjell dosjet e nëpunësve tek z. A.A.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën e ka parashtruar ndaj mos kthimit të përgjigjes ndaj kërkesës, dhe kërkon që organi i punësimit të nxjerrë akt administrativ për të gjitha kërkesat e parashtruara nga ankuesi si dhe te zbatohen në mënyrë të plotë e të drejt shtesa për kushte të tregut për punëtorët e AKP-se të cilët janë bursistë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, ju referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj, përcaktohet se: *“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshitjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, konstaton se ankesa e ankuesit e datës 23.09.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parakohshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që institucioni punëdhënës lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 23.07.2025, me date 19.08.2025 ka kërkuar nga ankuesi që të dërgohet dosja për shqyrtim tek Komisioni lidhur me shtesën për kushte të tregut, ndërsa me date 22.08.2025 dosjen e ankuesit e pa përcjell tek z A.J për shqyrtim të mëtejshëm. Ndërsa ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 23.09.2025, e që sipas Kolegjit të Këshillit, i njëjti fillimisht është dashur të pres deri në marrjen e vendimit të Komisionit për shtesën për kushte të tregut në Ministrinë e Financave, sepse afti i fundit për parashtrimin e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër heshitjes administrative është me datë 05.10.2025. Pas

marrjes se vendimit të Ministrisë së Financave respektivisht komisionit për shtesë për kushte të tregut ankuesi nëse pretendon se ka baze ligjore se i është shkelur ndonjë e drejtë mund të parashtroje ankesë të re pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Andaj, nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.09.2025 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.”

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1727/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit A.I;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Komisionit për Kushte të Tregut në Ministrinë e Financave dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.